

**VENDIM**  
**Nr.238, datë 27.2.2008**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR  
MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 15 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2008, për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në programin “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, zëri “Shpenzime korente” të shtohet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të konektivitetit, për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në Tiranë, fond, i cili t’i pakësohet programit “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, zëri “Shpenzime për mallra dhe shërbime”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**